

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Presidenca zbardh konkluzionet e mbledhjes së Këshillit të Sigurimit: Institucionet jo në garë me njëri-tjet rin, t'u tregojnë qytetarëve se sistemi di të korrigjojë vetveten
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/presidenca-zbardh-konkluzionet-e-mbledhjes-se-keshillit-te-sigurimit-in-i588931
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 11:35:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 11:35:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	22d61f94ccf5569512a0bcf145c6090b2827f5729f8cedda01c097ab8f8e479d
TEKSTI	206374738afbddd2ad0767cb7653f99f5ba76b8cf517d118c4d6155d9ffe3cd
PAMJA	674bf7f76597cc5a2f3da4d145550ecc374a18608a8ccb620a12ce801470c9e7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7de1b9f94a04b50320e0654cdcc7f60a254c60421cb11de49a9c9b292299b0c8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7de1b9f94a04b50320e0654cdcc7f60a254c60421cb11de49a9c9b292299b0c8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by


English

ie [Presidenca zbardh konkluzionet e mbledhjes se Keshillit te Sigurimit: Institucionet jo ne gare me njeri-tjetrin, t'u tregojne qytetarëve se sistemi di te korrigoje vetveten](#)
fundit

Presidenca zbardh konkluzionet e mbledhjes së Këshillit të Sigurimit: Institucionet jo në garë me njëri-tjetrin, t'u tregojnë qytetarëve se sistemi di të korrigojë vetveten



28 Shtator 2026, 13:35Politika TEMA



Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, ka shpërndarë për publikun konkluzionet e mbledhjes së Këshillit të Sigurimit Kombëtar, të thërritur këtë të hënë prej tij. Në mbledhje u diskutuan çështjet e aktualitetit dhe impaktin që ato kanë mbi veprimtarinë e institucioneve të sigurisë.

Në mbledhje, përveç anëtarëve që përcakton ligji, ishin të ftuar edhe institucioni e Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK-u.

“Këshilli diskutoi për situatën dhe masat që duhet të merren nga institucionet për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, bashkëpunimin me partnerët dhe aleatët dhe forcimin e besimit të publikut.

Në takim u konkludua se: Për sigurinë kombëtare, institucionet nuk konkurrojnë me njëri-tjetrin. Ato kanë përgjegjësi të ndryshme, por i shërbejnë të njëjtit interes: sigurisë së Republikës së Shqipërisë. Çdo mosbesim institucional të zëvendësohet me bashkëpunim, koordinim dhe komunikim profesional.

Hetimet e drejtësisë të zhvillohen tërësisht të pavarura dhe të respektohen nga të gjithë. Çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi ndaj shtetit dhe ndaj institucioneve të sigurisë.

Institucionet t'u tregojnë qytetarëve se sistemi di të korrigojë vetveten e të mbrojë interesin publik. Detyra jonë është të forcojmë standardet, kontrollin, transparencën, llogaridhënien dhe bashkëpunimin institucional.

Shqipëria ka institucione, ka partnerë dhe aleatë ndërkombëtarë, ka profesionistë dhe kapacitete. Institucionet e Republikës të punojnë së bashku për të forcuar shtetin, sigurinë kombëtare dhe besimin e qytetarëve”, thuhet në njoftimin e Presidencës.

Këshilli i Sigurimit Kombëtar nuk merr vendime. Ai është organ këshillimor i Presidentit të Republikës dhe mbështet Presidentin në ushtrimin e kompetencave kushtetuese dhe ligjore. Mbledhjet e tij zhvillohen të mbyllura.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Balla u drejtohet europarlamentarëve në Tiranë: Vëreni në krye të agjendës ratifikimin e aderimit të Shqipërisë në BE](#)

13:30 Politika

Rama mbledh ministrat dhe drejtuesit e qarqeve në “Vilën e Kuqe”

13:20 Politika

Mbledhja e Këshillit të Sigurisë, reagon Presidenca: Hetimet të jenë të pavarura, çështjet individuale të mos kthehen në krizë besimi ndaj shtetit

12:53 Politika

VIDEO/ Rama ndërhyr me batuta gjatë fjalës së raportuesit për Shqipërinë në PE: Aman, s'i lë dot gjermanët të presin

12:10 Politika 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.